

UDHËZIM
Nr. 31, datë 13.8.2020

PËR DEKLARIMIN PËR PUNËSIM TË SHTETASVE TË VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE ZONËS SHENGEN, ANËTARËVE TË FAMILJES TË SHTETASVE TË VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE ZONËS SHENGEN, QË NUK JANË SHTETAS TË KËTYRE VENDEVE, SHTETASVE TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, SHTETASVE TË KOSOVËS, BOSNJË-HERCEGOVINËS, MALIT TË ZI, SERBISË DHE MAQEDONISË SË VERIUT, SI DHE SHTETASVE QË PUNËSOHEN NË SEKTORË TË NDRYSHËM ME QËLLIM RREGULLIMIN E PASOJAVE DHE RIMËKËMBJEN NGA FATKEQËSI NATYRORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 71, 72 dhe 147 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe nenit 10 të ligjit nr.13/2020, datë 12.02.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, ‘Për të huajt’”, i ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen, anëtarët e familjes të shtetasve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen që nuk janë shtetas të këtyre vendeve, shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shtetasit e Kosovës, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe shtetasit që punësohen në sektorë të ndryshëm me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore, deklarimi për punësimin e të cilëve bëhet nga punëdhënësi ose vetë i huaji i vetëpunësuar apo investitor, në zyrën e punësimit në vendin ku kryhet aktiviteti, të pajisen me dokument që vërteton deklarinin e tyre për punësim.

2. Punëdhënësi ose i huaji i vetëpunësuar apo investitor të aplikojë on-line në portalin e-Albania, duke plotësuar formularin “Kërkesë për vërtetim deklarimi për punësim”, dhe bashkëlidhur me të dokumentacionin e poshtëshënuar:

- a) pasaportë ose dokument identifikimi (kopje);
- b) certifikatë familjare, ose dokument që vërteton marrëdhënien familjare, për anëtarët e familjes së shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen që nuk kanë shtetësinë e këtyre vendeve;
- c) kontratë qiraje (kopje) ose vetëdeklarim për adresën e banimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të shtetasit të huaj;
- d) kontratë pune me punëdhënësin për llogari të të cilit kryen aktivitetin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë për të punësuarit, ose statusin dhe aktin e themelimit (për shoqëritë) ose vërtetim regjistrimi në QKB (për personat fizikë) për të huajt e vetëpunësuar, ose statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, ku në përmbajtje të rezultojë se investitori bën një investim për investitorët.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, i drejtohet zyrës përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës subjekti pranë të cilit do të transferohet ushtron veprimtarinë ekonomike, dhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në nivel qendror, nëse subjekti pranë të cilit do të punojë shtetasi i huaj, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik.

4. Zyrtari përkatës, në rast dyshimi mbi të dhënat dhe dokumentacionin e paraqitur, të përcjellë këtë informacion tek strukturat e Ministrisë së Brendshme.

5. Pajisja e të huajit me vërtetimin e deklarimit për punësim, të bëhet nga zyra përkatëse e punësimit ku i huaji ushtron aktivitetin e tij, në një afat kohor prej 5 ditë pune që nga dita e aplikimit.

6. Formulari i kërkesës për Vërtetimin e Deklarimit për Punësim dhe Format i Vërtetimit të Deklarimit për Punësim, është pjesë e këtij udhëzimi.

7. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij udhëzimi.

8. Urdhri nr. 70, datë 23.2.2018 “Për deklarinimin për punësim të shtetasve të Bashkimit Evropian, Zonës Shengen, shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shtetasve të Republikës së Kosovës dhe shtetasve të Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare”, dhe udhëzimi nr. 25, datë 9.9.2019 “Për deklarinimin për punësim të shtetasve të Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut të përkatësisë etnike shqiptare”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCËVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj



Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____.

DREJTUAR: AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE ____
ZYRËS SË PUNËSIMIT ____

FORMULAR – KËRKESË
Për lëshimin e vërtetimit të deklarinimit për punësim

1. TË DHËNAT E TË HUAJIT/INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

Z./Znj. ____

Mr./Ms. (Emri Mbiemri / Given name(s) Surname)

Lindur më ____

Born on (Data Muaji Viti / Day Month Year)

në ____

in (Vendlindja / Place and country of birth)

me shtetësi ____

Nationality

Me profesion ____

Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/
Type of document and number

Me adresë _____
Seat and address

2. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj: _____
Name of the employer
(Emri i Subjektit)

Me adresë: _____
Seat and address

Bashkëlidhur me këtë kërkesë gjeni:

- Pasaportë ose dokument identifikimi (kopje), specifiko: _____
- Certifikatë familjare, ose dokument që vërteton marrëdhënien familjare, vetëm për anëtarët e familjes së shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen që nuk kanë shtetësinë e këtyre vendeve. specifiko _____
- Kontratë qiraje (kopje) ose vetëdeklarim për adresën e banimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të shtetasit të huaj. specifiko _____
- Kontratë pune me punëdhënësin për llogari të të cilit kryen aktivitetin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë për të punësuarit, ose statusin dhe aktin e themelimit (për shoqëritë) ose vërtetim regjistrimi në QKB (për personat fizikë) për të huajt e vetëpunësuar, ose statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, ku në përmbajtje të rezultojë se investitori bën një investim për investitorët. specifiko _____

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)



Tiranë, më____.____.____.

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar vërtetohet se, është bërë deklarimi për punësim, pranë kësaj zyre, për shtetasin e huaj (i cili përjashtohet nga detyrimi i pajisjes me leje pune dhe certifikatë regjistrimi pune) me të dhënat e mëposhtme:

DREJTOR